




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS  
KËSHILLI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS



NDIHMJA JURIDIKE | PRAVNA POMOC  
LEGAL AID

Nr. 13 /2021  
Datë: 17.06.2021

Këshilli për Ndhmë Juridike Falas, në pajtim me dispozitat e nenit 13 paragrafit 1 nënparagrafit 1.2 si dhe nenin 21 paragrafin 1 të Ligjit 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas si dhe duke u bazuar në nenin 40 të Ligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 17.06.2021 me votim unanim mori këtë:

**V E N D I M**


- I. Miratohet fillimi i procedurës së rekrutimit për emërimin e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas.
- II. Obligohet Njësia për Burime Njerëzore si njësi përgjegjëse në kuadër të Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas që të zhvilloj të gjitha procedurat e rekrutimit për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas, duke u bazuar në dispozitat e legjislacionit për Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas dhe në legjislacionin për zyrtarët publikë.
- III. Ftohet Ambasada Britanike që të marr pjesë në procesin e rekrutimit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Këshilli për Ndhmë Juridike Falas në takimin e mbajtur me datë 17.06.2021, duke u bazuar në legjislacionin për Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas, legjislacionin për zyrtarët publikë si dhe duke marr parasysh Opinonin Ligjor të datës 20.04.2021 të Ministrisë së Punëve të Brendshme/Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pasi ka diskutuar për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë, ka konstatuar se në pajtim me obligimin ligjor si dhe autorizimin sipas Ligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë është kompetent për të vendosur për fillimin e procedurës së rekrutimit për emërimin e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas.

Duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me dispozitat e nenit 13 dhe 21 të Ligjit 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas si dhe në pajtim me dispozitat e legjislacionit për zyrtarët publik, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi për miratimin e fillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas.

  
**Beshir Islami, Kryesues**  
**Këshilli për Ndhmë Juridike Falas**



Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit Ekzekutiv;
- Anëtarëve të Këshillit;
- Njësies për Burime Njerëzore në ANJF;
- Arkivit të Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas.